

Sharrcem Fakte

FORUMI I PARË I PALËVE TË INTERESIT NË HAN TË ELEZIT – 28.10.2013

Sharrcemi e ka organizuar një ngjarje për palët lokale të interesit ku nikoqir ishte Kryesuesi i Komitetit të CSR, Z Enver Curri i mbështetur nga anëtarët e Task Forcës së CSR. Ngjarja është mbajtur në Qendrën e Kulturës së Komunitetit të Komunës dhe aty mori pjesë edhe kryetari i Komunës Z. Rufki Suma si dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Komunës por edhe një numër i madh i qytetarëve.

Task Forca e ka prezantuar raportin e vet të detajuar për CRS për vitin 2012 si dhe aktivitetet e deritanishme të vitit 2013, derisa DM i kompanisë e ka dhënë një përmbledhje për planet e së ardhmes dhe i ka identifikuar



prioritetet për kontributin shoqëror. Pas theksimit të kryesuesit se kjo ngjarje ka për qëllim të krijojë transparencë përmes shpalosjes ose publikimit ju dha fjale edhe qytetarëve ku pastaj filloj edhe një shkëmbim shumë frytdhënës i ideve dhe informatave. Ishte kjo ngjarja e parë e kësaj natyre që kishte ndodhë në komunitet dhe ne e konsiderojmë si të suksesshme pasi që kishte një pjesëmarrje dhe interaktivitet të gjerë nga qytetarët.

FORUMI I PARË I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT – PRISHTINË 29.01.2014

Forumi ishte organizuar nga Rrjeti Kosovar i dhe nga Oda Ekonomike e Kosovës. Si nikoqir i ngjarjes Fabrika e prodhimit të çimentos Sharrcem për herë të parë në Kosovë e ka prezantuar raportin mbi politikat dhe praktikat e kompanisë për Qëndrueshmërinë e Përgjegjësisë Shoqërore Korporative (CSR).

Dhe në këtë ngjarje është theksuar se me themelimin e “Labororit të Aktiviteteve të Biznesit” (LAB), i gjithë komuniteti i Hanit të Elezit do të përfitojë nga themelimi i ndërmarrësve të Vogël & Mesëm për zhvillim në fushën e Bujqësisë. Kjo OJQ do të financohet nga Sharrcem dhe do të jetë një entitet i ndarë nga kompania dhe e njëjta do të udhëhiqet nga një bord i pavarur si një shoqatë jo fitimprurëse.





Në forum kanë marrë pjesë Ministri i Bujqësisë, Blerand Stavileci, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bernard Nikaj, Zëvendës Ministri i Ambientit Shpetim Rudi, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kryesuesi i Rrjetit Kosovar të CSR, Menaxheri i Projektit – Anëtarësimi dhe marrëdhëniet e palëve të interesit nga CSR Evropë dhe një numër i madh i palëve të tjera të interesit nga

komuniteti i donatorëve, institucionet dhe shoqëria civile, të cilët e mbështetën nocionin se të gjitha bizneset që veprojnë në Kosovë janë të obliguar ti pranojnë praktikrat e CSR dhe që në mënyrë transparente të raportojnë për kontributin e tyre në komunitetin ku ata veprojnë.

FORUMI I ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT TË –LAB, më 06.05.2014 Hani i Elezit

Sharrcemi vazhdon të bëjë investime përfitues të cilave janë fillimisht dhe më së shumti qytetarët, dhe si rrjedhojë ka alokuar gjysmë milioni euro për projektin e Laboratorit të Aktiviteteve të Biznesit (LAB) duke mundësuar krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushën e bujqësisë. Në takim ishin prezent edhe Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma Ministri i Bujqësisë, Pzlltarisë dhe Zhvillimit Rural, Halit Hoxhaj, Evangelos Vergos, nga Shkolla Amerikane e Bujqësisë në Thessaloniki. Ai theksoj se rezultatet pozitive arrihen vetëm përmes bashkëpunimit.



Shumë qytetarë që ishin prezent në forum e kanë mirëpritur këtë projekt dhe e kanë shprehur vullnetin e tyre për të bashkëpunuar për gjithçka që shpie drejtë komunitetit më të mirë si tërësi.



Laboratori i Aktiviteteve të Bizneseve (LAB) është iniciuar posaçërisht për ti mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Han të Elezit, për të krijuar vende të reja pune dhe për ta zbutur varfërinë. Projekti do të fokusohet në edukimin, trajnimin dhe pajisjet e ndërmarrjeve në fushën e bujqësisë.

SHARRCEM

a  TITAN Group Company



Group Corporate Values

